



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K2/XH4-6 Prot.
Nr. Dok. 202503180/6

Tiranë 27/10/2025

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave për të garantuar përfaqësimin e akuzës në procesin gjyqësor me objekt: "Shqyrtimin e kërkesës për rivendosje në afat të ankimit dhe pezullim të ekzekutimit të vendimit penal nr. 17, datë 16.01.2025." nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.*

**PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
Tiranë**

**PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
Tiranë**

**KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË
Tiranë**

**Për dijeni: KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
Tiranë**

**INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
Tiranë**

E/I nderuar,

Në ushtrim të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, Avokati i Popullit i kushton vëmendje të posaçme respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë shqyrtimit të çështjeve gjyqësore nga gjykatat e të gjitha niveleve, përfshirë edhe rolin e organeve të akuzës. Garantimi i zhvillimit të drejtësisë me cilësi të lartë dhe brenda afateve të arsyeshme në interes të qytetarëve, mbetet një nga prioritetet kryesore në punën e Avokatit të Popullit, ndonëse jemi të vetëdijshëm për sfidat që po kalon sistemi i drejtësisë në këtë fazë riorganizimi, në kuadër të reformës në drejtësi.

I. Parashtrimi i rastit.

Në institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur një ankesë shtetasi Xh. S., aktualisht i ndaluar për të vuajtur dënimin në IEVP Lushnje, i cili pretendon për zvarritje të procedurave të shqyrtimit gjyqësor të kërkesës së tij me objekt “*Rivendosje në afat të ankimimit kundër vendimit nr. 17, dt.16.01.2025 Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit deri sa të shqyrtohet çështja nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.*” **për arsye të mungesës në seancat gjyqësore të prokurorit përfaqësues i akuzës në emër të organit të prokurorisë Tiranë.**

Ky shtetas është dënuar në mungesë për veprën penale “Dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a/1i Kodit Penal, **me 6 (gjashtë) muaj** burg nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhe në mungesë të njoftimit të vendimit, nuk ka mundur të ushtrojë të drejtën e ankimimit, duke bërë që ky vendim të marr formë të prerë.

Ankuesi shprehet se në 5 (pesë) seancat gjyqësore të caktuara nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe të njoftuara palëve paraprakisht, përfshirë dhe organin e akuzës, nuk është zhvilluar asnjëra vetëm për arsyen e mosparaqitjes së prokurorit në seancë, duke bërë të pamundur shqyrtimin gjyqësor dhe si rrjedhojë duke i mohuar qytetarit të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Konkretisht seanca e datës 14.05.2025 ora 10:00, seanca e datës 29.05.2025 ora 10:00, seanca e datës 18.06.2025 ora 11:45, seanca e datës 08.07.2025 ora 12:00 dhe seanca e datës 21.07.2025 ora 13.00.

Rezulton se që nga data 23.04.2025 dhe deri në datën 21.07.2025 nuk është zhvilluar asnjë seance gjyqësore, pra për më shumë se 3 (tre) muaj dhe seanca e radhës është caktuar në datën 15.09.2025 ora 12.30.¹

Shtetasi Xh. S. pothuajse po përfundon vuajtjen e dënimit prej 6 muajsh në burg, pa patur mundësinë të ushtrijë të drejtën e ankimit si dhe duke ju mohuar e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Sipas ankuesit, prokurori me mosprezencën e tij ka cënuar të drejtën e një procesi të rregullt ligjorë siç është gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, garantuar nga neni 6 i KEDNJ-së dhe neni 63 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në këto kushte, ankuesi iu drejtuar Avokatit të Popullit për të kërkuar ndërhyrjen pranë institucioneve përkatëse të sistemit të drejtësisë, me qëllim respektimin e të drejtave të tij themelore. Në përputhje me nenin 25 të Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, i cili parashikon shqyrtimin e ankesave që lidhen me administratën e pushtetit gjyqësor dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, pa cenuar pavarësinë e gjykatave, rasti u vlerësua si brenda kompetencës dhe u regjistrua për shqyrtim administrativ².

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese, bazuar në nenin 63, paragrafi i katërt i Kushtetutës, ku parashikohet se: “*Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij*”, në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, respektivisht në nenin 19, gërma “b” ku parashikohet se: “*Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin*”, me shkresën

¹ Shkresa nr. K2/XH4-1Prot. datë 29.07.2025 “Ankesë” Xhevahir Simoni.

² Neni 25 i Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, i cili shprehet se: “Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit”.

nr. K2/Xh4-2 Prot. datë 13.08.2025 “Kërkesë për informacion”, i kërkuam informacion Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Organi i prokurorisë në përgjigjen e saj me shkresën nr. 21180/1 prot. datë 15.09.2025 na bënë me dije se: “ Çështja në fjalë ka qënë në ndjekje nga prokurorja E. Alvora e cila e ka dorëzuar atë pa kryer veprime të mëtejshme. Aktualisht çështja i ka kaluar prokurores E. Shehu.”

Nga informacioni i marrë në faqen zyrtare të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, rezulton se më datën 16.07.2025, KPA ka vendosur pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit E. Alvora për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.

Në përgjigje e organit të prokurorisë konfirmohet mungesa e prokurorit në seancat gjyqësore, mungesë prej 5 (pesë) seancave të njëpasnjëshme, e cila bie ndesh me detyrat dhe funksionet e prokurorit, përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale, si dhe në Ligjin nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Ndalemi të theksojmë se, problemi i mungesës së prokurorëve në seancat gjyqësore, duke e bërë të pamundur zhvillimin e tyre, nuk është në nivelin e një apo disa rasteve sporadike por një shqetësim që u ngrit dhe në takimet që përfaqësuesit e Avokatit të Popullit patën me drejtuesit në organet e prokurorisë dhe gjykatat në disa rrethe gjyqësore të vendit.

II. Vlerësimi i Institucionit të Avokatit të Popullit

Nga hetimi administrativ i kryer, u konstatua se mangësitë në përfaqësimin e akuzës në seancat gjyqësore nuk përbëjnë raste të izoluar. Edhe pse kuadri ligjor penal dhe aktet nënligjore ofrojnë rregullime të nevojshme, vlerësohet se ekziston ende hapësirë për ndërhyrje të brendshme organizative, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe garantimin e një administrimi më të mirë të ndjekjes penale.

Organi i Prokurorisë, duhet të ushtrojë kompetencat e tij duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë, e të rregullt ligjor dhe në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe interesit publik. Cilido ka të drejtë të trajtohet i barabartë përpara ligjit dhe të prezumohet i pafajshëm, deri në momentin kur ndaj tij të jepet një vendim

gjyqësor i formës së prerë. Pavarësisht ngarkesës së madhe të punës, rritja e efikasitetit dhe e efektivitetit të prokurorisë është thelbësore për të garantuar një proces të drejtë të ndjekjes penale.

Në Kodin e Procedurës Penale, neni 24³ si dhe pika 3 e nenit 348, përcaktojnë detyrimin e prokurorit, përfaqësuesit të akuzës, për të qënë prezent në gjykimin e çështjes, konkretisht pika 3 e nenit 348 e K.Pr.P. shprehet: “Nëse prokurori nuk paraqitet në gjykim, gjykata shtyn seancën dhe njofton drejtuesin e prokurorisë.” Nga kjo dispozitë kuptojmë domosdoshmërinë e prezencës së prokurorit në gjykim, mungesa e të cilit çon në shtyrjen e afateve të gjykimit të çështjes.

Bazuar në ligjin nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në pikën k) të nenin 42 “Kompetencat e drejtuesit në drejtimin e prokurorisë”, është përcaktuar se: “*Drejtuesi i prokurorisë mbikëqyr respektimin e etikës së prokurorit dhe planifikimin e punës së tyre, si dhe përmbush angazhimet ligjore për vlerësimin profesional të prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore*”.

Në rastin në fjalë që po referojmë, konstatohet se nuk është ndërmarrë asnjë veprim si nga ana e organit të prokurorisë dhe nga ana e gjykatës për të siguruar pjesmarrjen e prokurorit në seancën gjyqësore.

Aksesi në drejtësi dhe zbatimi me rigorozitet i parimeve bazë të një procesi të rregullt ligjor, duhet të udhëheqin punën dhe veprimtarinë e organeve të drejtësisë. Organet e drejtësisë si dhe çdo institucion publik duhet t’i shërbejnë qytetarëve me integritet të lartë profesional dhe të garantojnë standartet më të larta të respektimit të ligjit dhe të të drejtave themelore të individit.

Në vlerësimin e Avokatit të Popullit e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ligjor është një ndër të drejtat themelore të qytetarëve shqiptarë. Për këtë arsye, kjo e drejtë nuk është dhe nuk duhet të mbetet një e drejtë apo garanci deklarative, por është një standard

³ Neni 24 “Funksionet e prokurorit” K.Pr.P., përcakton: “1. Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr ekzekutimin e tyre, si dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod”

kushtetues, i garantuar dhe i sanksionuar në aktet që përcaktojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si në nivel ndërkombëtarashtu edhe në të drejtën e brendshme të vendit.

Pavarësisht vështirësive që kalon sot sistemi i drejtësisë, si mungesa e burimeve njerëzore, infrastruktura dhe transferimet e shpeshta të magjistratëve, sjellje si neglizhenca dhe mosushtrimi i detyrave nga magjistratët që cenojnë të drejtën për proces të rregullt ligjor, nuk mund të anashkalohet nga organet mbikqyrëse të sistemit të drejtësisë por duhen adresuar.

Në ushtrim të detyrave dhe fushës së kompetencave, organet e prokurorisë duhet të veprojnë për të moslejuar zvarritje të papërligjura dhe arbitrare nga ana e gjyqtarëve apo prokurorëve.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me qëllim rritjen e efikasitetit të gjykatave, bazuar në parimet e mirëqeverisjes, efektivitetit, transparencës dhe një mirëadministrimi të procesit gjyqësor, ka marrë Vendimin nr. 433 datë 22.07.2025 “Përcaktimi i rregullave për afatet standarde minimale kohore dhe standardet minimale sasiore të gjykimit të çështjeve”⁴.

Është e vërtetë se afatet e përcaktuara në këtë vendim janë orientuese për gjyqtarët, por ato kanë për qëllim orietimin në drejtim të mirëadministrimit të procesit dhe rritjen e efektivitetit të gjyqtarëve, çka tregon dhe vëmëndjen e shtuar ndaj këtij fenomeni i cili po cënon standartet e një procesi të rregullt ligjorë të përcaktuara dhe në nenin 6 të KEDNJ-së.

Neni 6 i KEDNJ-së zë një vend të rëndësishëm në tërësinë e të drejtave që garanton kjo konventë. Një proces i rregullt ligjor në çështje civile dhe penale është një element bazë i parimit të shtetit të së drejtës. Midis garancive që lidhen direkt ose indirekt me veprimtarinë e gjykatës janë ndër të tjera: publiciteti i gjykimit (seancat e hapura dhe shpallja e vendimit publikisht), mënyra e zhvillimit të rregullt të seancave gjyqësore, konkretisht elementë të tillë si: barazia e armëve, afati i arsyeshëm, arsyetimi i vendimeve, etj.

⁴ Vendimin nr. 433 datë 22.07.2025 “Përcaktimi i rregullave për afatet standarde minimale kohore dhe standardet minimale sasiore të gjykimit të çështjeve”. Sek.II pika 1 gërma a) Afatet standarde minimale kohore në seksionin penal të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm janë si më poshtë:
a. Kërkesat penale jo më gjatë se 2 muaj.

GJEDNJ-ja me vendimet e saj ripohoi se shtetet kanë një detyrim të përgjithshëm për të organizuar sistemet e tyre ligjore në mënyrë që të siguronin përputhjen me kërkesat e nenit 6, paragrafi 1, të Konventës, duke përfshirë atë të një gjykimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm.

Në muajin tetor /2021 GJEDNJ ka vendosur për rastin e dy kërkuesve, Bara and Kola v. Albania, shtetas shqiptarë që janë ankuar pranë këtij institucioni për kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore në Shqipëri. Kjo Gjykatë ka vendosur se në këto raste është shkelur e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm⁵.

Në referim të vendimeve të GJEDNJ⁶, por edhe praktikës së saj në përgjithësi “*case law*”, gjykatat vendase kanë detyrimin që të respektojnë parimin e rëndësishëm “*të përfundimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm*”. Sa më sipër, si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor, ky parim garanton mbrojtjen e të gjitha palëve të përfshira në procesin gjyqësor ndaj “*vonesave të tepruara procedurale*”, që në administrimin e drejtësisë rrezikojnë të drejtat e palëve dhe shtetin e së drejtës. Një vendim i vonuar madje mund të zhbëjë dhe vetë arsyen për të cilën është dhënë vendimi, pasi dhënia e tij në vonesë, mund të bëjë që ai të jetë krejt i pavlefshëm për palën e interesuar. Një drejtësi jo efikase dhe e vonuar çon në dëmtimin e besimit të qytetarëve tek institucionet e shtetit.

Në këtë frymë të ligjit është shprehur dhe Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.12. datë 05.03.2012, ku ka arsyetuar se: “*Arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së sipas së cilës arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke patur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuesit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuesin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit*”. (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.69 datë 17.11.2015, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 29.06.2022)

⁵ Bara and Kola v. Albania - 43391/18 and 17766/19, Judgment 12.10.2021

⁶ PGV kundër Italisë, vendimi i GJEDNJ, datë 7.11.2000; **Çështja X kundër Francës, 1998**; Vocaturo kundër Italisë; Cappello kundër Italisë; Darvan kundër Turqisë, 2009; Zimmermann dhe Steinner kundër Zvicrës, datë 13.06.1983; Vendimi K. Klitshe de la Grande kundër Italisë, 27.10.1994; Poiss kundër Austrisë, datë 23.04.1097.

Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vijimësi sa i përket procesit të rregullt ligjor, në koherencë me zbatimin e reformës në drejtësi është shprehur se: “... në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjyimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, por barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese)⁷.”

E drejta e gjyimit brenda një afati të shpejtë dhe të arsyeshëm është jo vetëm një garanci për mbrojtjen e palëve nga zvarritjet e paarsyeshme të procedurave, por mbi të gjitha garanton se brenda një afati të arsyeshëm pala kërkuese do të përfitojë eventualisht nga të drejtat që i janë mohuar, duke i mundësuar asaj siguri juridike në raport me pozitën procedurale.

Për më tepër, gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, përveçse është një standard të cilin organi gjyqësor ka detyrimin ta respektojë apriori, është mbi të gjitha një standard që vlerësohet në mënyrë të veçantë për secilin rast konkret, nisur nga specifika, kompleksiteti, tërësia e të drejtave të shkelura apo të pretenduara, etj.

Rasti të cilit i referohemi në këtë rekomandim, ankuesi Xh. Simoni pothuajse po përfundon vuajtjen e dënimit prej 6 muajsh në burg, (*dënuar në mungesë*) pa patur mundësinë të ushtrojë të drejtën e ankimit, si rrjedhojë e zvarritjes së procedurave gjyqësore nga mungesa e prokurorit në seancat e njoftuara.

Referuar Vendimit nr. 433 datë 22.07.2025 të KLGJ-së, në këtë rast ku kemi të bëjmë me një kërkesë penale, afati standard minimal kohor është përcaktuar **jo më gjatë se 2 muaj**.

Prokurori, në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit për ngritjen dhe mbrojtjen e akuzës, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor për t'i shërbyer çdo qytetari me integritet, paanshmëri dhe profesionalizëm, duke respektuar në mënyrë rigoroze të drejtat themelore të individit në dhënien e drejtësisë. Ky rol është i sanksionuar në nenin 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet qartë se “**prokurori ushtron ndjekjen penale në emër të shtetit dhe në interes të shoqërisë.**”

⁷ Vendimi Gjykatës Kushtetuese nr. 46, datë 03.10.2023, pika 21, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 162, datë 09.11.2023.

Avokati i Popullit në shqyrtim të këtij rasti si dhe të rasteve të tjera të ngjashme në disa gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, çmon se zvarritja e proceseve gjyqësore si pasojë e mos ushtrimit të detyrave funksionale të prokurorëve në mënyrë të përsëritur nevojitet të adresohen. Në këtë rast, konstatojmë se është cënuar e drejta për një proces të rregullt ligjor. Këto zvarritje ulin besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, ndërkohë që janë ndërmarrë reforma shumë të thella dhe shumë të kushtueshme në nivel kapacitetesh njerëzore dhe finaciare me qëllim për të rritur besimin e publikut te drejtësia.

Për sa trajtuam më lart, çmojmë se nga strukturat kompetente të cilat vlerësojnë performancën e punës së magjistratëve duhet të analizojnë veprimet dhe mosveprimet e prokurorit dhe gjyqtarit në raport dhe me pasojën që ka passjellë dhe të mbahet qëndrim ligjor mbi veprimet/mosveprimet përkatëse.

Në analizë të këtij rasti dhe në përgjithësi të problematikës së evidentuar më lart, vlerësojmë se, bazuar në nenet 38 dhe 42 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Prokurori i Përgjithshëm apo Drejtuesi i Prokurorisë duhet të nxjerrin udhëzime për planifikimin e punës, prezencën dhe njoftimin për mosprezencë në seancat gjyqësore të prokurorëve, për të shmangur vonesat e pajustificuara në procesin gjyqësor.

Organet drejtuese dhe vendimmarrëse të sistemit të drejtësisë si KLGJ, KLP, ILD, duhet të jenë të vëmendshëm dhe të vlerësojnë çdo adresim lidhur me funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe të kontribuojnë për të mos lejuar veprime apo fenomene të cilat do të mund të çenojnë përsëri besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

Për sa parashtruam më sipër, në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor *në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend* dhe me qëllim rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura ankuesit, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*”, në ligjin nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, respektivisht në nenin 21/b, ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”, dhe në nenin 21/c, ku parashikohet se: “*Avokati*

i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen,

REKOMANDOJMË:

1. Organi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të sigurojë pjesëmarrjen e përfaqësuesit të saj në të gjitha seancat e ardhshme gjyqësore të çështjes penale me palë shtetasin Xh. S., si dhe në çdo rast tjetër të ndjekjes penale ku është e nevojshme prania e prokurorit.
2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme, të verifikojnë shkaqet e mungesave të përsëritura dhe të merren masa të menjëhershme organizative dhe disiplinore ndaj prokurorëve, për të shmangur mungesat e pajustificuara të prokurorëve në seancat gjyqësore.
3. Të hartohen akte ku të përcaktohen procedura të brendshme për zëvendësimin automatik të prokurorit në rast pamundësie objektive dhe rasti të përsëritur, në mënyrë që proceset gjyqësore të mos pengohen.
4. Të sigurohet që çështjet që lidhen me **privimin nga liria** të trajtohen me **përparësi**, në respekt të standardeve të KEDNJ dhe jurisprudencës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi në ktheni përgjigje brenda 30 ditëve në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA

D V